



16 vjet në NATO: Kryeministri Rama, ministri i Mbrojtjes Vengu dhe lidershpi ushtarak, rikonfirmojnë angazhimin për sigurinë



» faqe 3



DHURIMI I ANIJES ITALIANE “LIBRA” PËR SHQIPËRINË: FORCIMI I KAPACITETEVE DETARE DHE BASHKËPUNIMIT STRATEGJIK

Në Portin e Durrësit u nënshkrua Marrëveshja e Mirëkuptimit mes shoqërisë “Fincantieri” dhe shoqërisë shqiptare “KAYO”, e cila shënon nisjen e bashkëpunimit për sipërmarrjen e përbashkët në industrinë ushtarake navale. Kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu vizitoi anijen...

» faqe 4



PA ARKIV NUK KA HISTORI, PA HISTORI NUK KA KOMB

Intervistë me drejtorin e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, Prof. Asoc. Dr. Teki Ali Kurti

Prof. asoc. dr. Teki Ali Kurti ka lindur në fshatin Gjon të Martaneshit, më 25 prill 1966. Është diplomuar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Në vitet 2000-2006 ka qenë për dy mandate rresht i zgjedhur si kryetar në organet e qeverisjes...

» faqe 6



VOTA, FORCA QË FORMËSON TË ARDHMEN

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

E drejta e votës është një e drejtë themelore demokratike, që u lejon qytetarëve të ndikojnë në qeverisjen dhe vendimmarrjen politike të vendit të tyre. Në shumicën e vendeve demokratike, vota është një e drejtë dhe një përgjegjësi e qytetarëve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre dhe për të ndikuar në politikat publike...

» faqe 8

Ministri Vengu dhe SHSHPFA, gjenerallettënant Arben Kingji, pritën kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiralin Giuseppe Cavo Dragone

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu dhe SHSHPFA, gjenerallettënant Arben Kingji, pritën në një takim zyrtar kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiralin Giuseppe Cavo Dragone. Takimi u zhvillua në një atmosferë miqësore dhe konstruktive, duke shënuar një moment të rëndësishëm të bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe NATO-s, në kontekstin e sfidave të përbashkëta të sigurisë në rajon dhe më gjerë. Ministri Vengu shprehu vlerësimin e tij për punën dhe përkushtimin e admiralit Dragone në drejtimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, si dhe për kontributin ndër vite në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe, veçanërisht në periudhat kur ai ka shërbyer në funksione të rëndësishme në Forcat e Armatosura italiane. Në qendër të diskutimeve ishte situata aktuale e sigurisë, kryesisht ajo në Ballkanin Perëndimor. Ministri Vengu theksoi rëndësinë që Shqipëria i kushton këtij rajoni si pjesë e pandashme e sigurisë Euroatlantike. Ai ritheksoi angazhimin e palëkundur të vendit tonë për misionin e NATO-s në Kosovë (KFOR), duke nënvizuar rolin thelbësor të këtij misioni për ruajtjen e stabilitetit në rajon.

Ndërsa nga ana e tij, SHSHPFA, gjenerallettënant Kingji diskutoi çështje me interes për Aleancën dhe vendin tonë, mbi situatën e sigurisë në rajon si dhe ndanë shqetësime të përbashkëta mbi këto sfida, duke



vlerësuar si shumë të rëndësishëm kohezionin dhe unitetin e Aleancës përballë situatave aktuale dhe atyre të pritshme. Nga ana e tij, admiral Cavo Dragone vlerësoi rolin e Shqipërisë si shembull pozitiv në Aleancë për sa i përket detyrimeve në kuadër të mbrojtjes kolektive. Në përfundim të takimit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerallettënant Arben Kingji e siguroi kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Giuseppe Cavo Dragone për përkushtimin e FARSH-ve, për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Aleancës.



Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu pritë ministrin e deleguar të Francës për Çështjet Evropiane, Benjamin Haddad



Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu pritë në takim zyrtar ministrin e deleguar të Francës për Çështjet Evropiane, Benjamin Haddad.

Gjatë takimit, ministri Vengu vlerësoi mbështetjen që Franca i jep Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. “Vitet e fundit, nën lidhshiripin e kryeministrit Rama dhe presidentit Macron, marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Francës, veçanërisht pas vizitave të ndërsjella historike në Tiranë më 2023 dhe Paris më 2024 dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të reja ndërqeveritare në vazhden e Partneritetit Strategjik, që lidh dy vendet tona, në fushat prioritare të inovacionit, infrastrukturës, arsimit, energjisë dhe së fundmi të sigurisë dhe mbrojtjes”, - u shpreh Vengu.

Ministri i Mbrojtjes nënvizoi rëndësinë shumë të veçantë që mbart për vendin dhe rajonin tonë zhvillimi i Samitit të Komunitetit Politik Evropian në Tiranë më 16 maj, si edhe kënaqësinë për pjesëmarrjen e Presidentit Macron në samit dhe vizitën bilaterale të tij në Shqipëri.



16 vjet në NATO: Kryeministri Rama, ministri i Mbrojtjes Vengu dhe lider shipi ushtarak, rikonfirmojnë angazhimin për sigurinë

Me rastin e 16-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Kryeministri Edi Rama i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralletënant Arben Kingji, vizituan repartin ushtarak të Zall Herrit, ku diskutuan jo vetëm mbi arritjen e këtyre viteve, por edhe ato që konsiderohen si sfida të Forcave të Armatosura.

Fjalën e hapjes në këtë takim e mbajti drejtori i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, z. Haki Çako, i cili bëri një rezumë të punëve të bëra deri tani nga struktura që drejton dhe me objektiv arritjen e synimeve dhe ndihmën që Shqipëria të avancojë në rrugën drejt integritimit në BE.

Z. Çako tha se Mbrojtja Civile dhe Emergjencat janë përfshirë në dhjetëra operacione shpëtimi brenda vendit, por edhe në disa të tjera jashtë Shqipërisë, ku ndihmuan partnerët e tyre, si në Greqi apo Turqi.

Ndërsa ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu nënvizoi punën e bërë këto vite dhe situatën ku e gjen 16-vjetori i anëtarësimit të vendit në NATO. “Një ngritje e trefishtë në raport me strukturat e NATO-s, angazhim ushtarak me vepra dhe jo me fjalë, ku 500 ushtarakë shqiptarë do gjenden në misione jashtë vendit, por edhe nivelin e përgatitjes me demonstrimin që u tregua edhe sot”.

Më tej ai shtoi se për herë të parë Mbrojtja dhe Siguria nuk kanë më problematika financiare.

Më tej në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu vlerësoi punën, përpjekjen dhe sakrificën e çdo efektivit të Forcave të Armatosura, familjeve të tyre dhe të gjithë drejtuesve të FA-së ndër vite, si një kontribut i vyer për Shqipërinë dhe NATO-n: “Ky përvjetor i 16-të i anëtarësimit tonë në Aleancën me të fuqishme dhe më jetëgjatë të historisë moderne, na gjen në një situatë krejt tjetër. Në rrafshin e bashkëpunimit politik për sigurinë dhe mbrojtjen në rajon, kemi treguar se mund të udhëheqim një seri iniciativash në dobi të stabilitetit dhe integritetit euroatlantik të rajonit dhe linjëzimi ynë me BE-në vjen dhe me vepra, jo vetëm me fjalë në rrafshin e angazhimit ushtarak.

Përballë këtyre sfidave, kryeministri Rama foli jo vetëm për fuqizimin e ushtrisë shqiptare, por për shndërrimin e vendit në një fuqi prodhuese dhe eksportuese të municioneve luftarake.

“Është vërtetë e dhimbshme që në aspektin e ushtrisë tonë në komunitetin euroatlantik, të gjithë bënë përpjekjet e tyre, në aspektin e përkujdesjes dhe mbështetjes së ushtrisë sonë, Shqipërisë i ndodhi çfarë s’i ka ndodhur asnjë vendi tjetër: një rënie në humnerë dhe pastaj braktisje shumë e gjatë. Ky është i vetmi aset i trashëguar nga e shkuara, aseti i drejtuesve të shkuar të Forcave të Armatosura, duke i mbijetuar me vështirësi një sfide të paparë, si rezultat i shembjes së shtetit dhe pastaj i kthimit të kurrizit nga ana e shtetit ndaj Forcave të Armatosura. Kemi dhjetëfishuar investimet dhe financimet në ushtri”, - tha kryeministri.

Kryeministri Rama tha se Qeveria është e hapur për bashkëpunime, ndërsa thirrjen ia drejtoi kryesisht kompanive të huaja: “Ftojme edhe partnerët dhe kompanitë e huaja për bashkëpunim me industrinë tonë KAYO dhe ne do jemi vend eksportues i industrisë ushtarake në të ardhshmen dhe po shohim pikat e bashkëpunimit me industrinë dhe vendet e tjera për ta arritur këtë. Do kenë paga dinjitoze dhe sipas kërkesave të tyre”.

Rritja e kapaciteteve dhe rijetëzimi i industrisë ushtarake, kryeministri tha se do të ecë paralelisht edhe me rritjen e pagave për Forcat e Armatosura.

“Është rritur me pesëfish numri i rekrutimeve. Nga ushtria më e keq paguar është kthyer në ushtria më e mirë paguar në rajon dhe gati me standardet e NATO-s. Kemi rritur rrogat deri në



1550 euro dhe kemi bërë atë që kemi premtuar. Pra kemi objektiv mesataren e pagës mesatare të ushtrisë së vendeve të përparuara të NATO-s, jemi afër asaj dhe po vijojmë punën për të arritur atje”, - vijoi Rama.

Kreu i qeverisë, teksa përmendi vështirësitë ndër vite, pas rrënimit të ushtrisë, vuri në dukje se aktualisht kemi ushtrinë më të mirë paguar të rajonit.

Kryeministri theksoi më tej edhe mbështetjen e dhënë efektivëve të ushtrisë me programin e 179 kredive të buta për familjet e tyre dhe të tjerat në proces, dyfishimin e numrit të vajzave të rekrutuara apo studente në ushtri dhe pesëfishimin e studentëve të akademisë në një dekadë.

Ndërsa nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralletënant Arben Kingji u shpreh se: “Në këto 16 vjet, është forcuar imazhi i Shqipërisë si faktor sigurie dhe stabiliteti në rajon dhe më gjerë”. Teksa përmendi investimet e kryera për modernizimin e FA-së, gjeneralletënant Kingji tha se: “Vizioni është i qartë: Të krijojmë një Forcë të Armatosur të mirë trajtuar, të mirë trajnuar, të mirë pajisur, me qëllimin që të përballojë sfidat e së nesërme, të realizojë misionin kushtetues dhe të kontribuojë në operacionet e përbashkëta”.



Në Portin e Durrësit u nënshkrua Marrëveshja e Mirëkuptimit mes shoqërisë “Fincantieri” dhe shoqërisë shqiptare “KAYO”, e cila shënon nisjen e bashkëpunimit për sipërmarrjen e përbashkët në industrinë ushtarake navale. Kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu vizitoi anijen Libra dhe mori pjesë në nënshkrimin e dokumenteve të bashkëpunimit.

Kryeministri tha se ky akt është dëshmi e miqësisë dhe bashkëpunimit mes vendeve, i cili po hyn në një epokë të re, duke prodhuar energji të reja.

Teksa falënderoi miqtë italianë, kryeministri Rama tha se marrëdhënia me Italinë mike përmes këtij bashkëpunimi bëhet akoma edhe më e rëndësishme, më strategjike dhe më e lidhur me interesat e përbashkëta të të dy vendeve, të dy kombeve tona. “Sigurisht kjo anije, është një dëshmi shumë e dukshme dhe e prekshme e gjithë asaj që po bëjmë bashkërisht dhe dua të siguroj të gjithë se, ajo që po bëjmë së bashku, është shumë më tepër se sa kjo anije dhe është shumë më tepër sesa aspekti material sepse po punojmë vërtetë për të krijuar një sinergji të rëndësishme ndërmjet këtyre dy anëve të Adriatikut dhe për të bërë bashkë ide të reja dhe energji të reja, për të shkuar përpara dhe për të transformuar gjithnjë e më shumë këtë miqësi shumë të lashtë, në diçka të mirë për të dy popujt tanë dhe për të dy shtetet tona.

Dua të falënderoj veçanërisht edhe të gjithë skuadrën ushtarake që ka ardhur nga Italia për këtë demonstrim të një bujarie të madhe, të një miqësie të madhe, të një respekti të thellë; dua të falënderoj veçanërisht kreun e palës ushtarake për mikpritjen dhe për kujtimin e bukur që do ta marr me vete për “xhevahirin” këtu afër, të anijes së marinës italiane. Nuk ndodh çdo ditë që të kesh një mundësi të tillë dhe faleminderit, Guido që më tregove një tjetër muze Italian, por këtë herë në det dhe jo në tokë. Është vërtetë një kënaqësi e jashtëzakonshme dhe dua të shpresoj që ushtarakët tanë, që kreu i forcave të marinës shqiptare të jenë të gëzuar. E di që ‘oreksi vjen duke ngrënë’, por ndërkohë duhet shijuar ‘kjo pjatë e madhe bujarie dhe mirësie’ nga ana e Italisë”, - u shpreh kryeministri Rama në përshëndetjen e tij.

Ndërsa, ministri Vengu, në fjalën e tij, tha se dhurimi i anijes “Libra” është një simbol i marrëdhënieve të shkëlqyera dhe të thella që ekzistojnë ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë.

Dhurimi i anijes italiane “Libra” për Shqipërinë: Forcimi i kapaciteteve detare dhe bashkëpunimit strategjik



Sipas tij, kjo anije është një mundësi për Forcën tonë Detare që të ndërmarrë tranzicionin nga forcë me detyra roje bregdetare, në një forcë luftimi moderne. “Ky akt thekson angazhimin e përbashkët për sigurinë dhe mbrojtjen dhe forcimin e partneritetit tonë në fushën e Mbrojtjes, veçanërisht në hapësirë adriatiko-joniane. Dhurimi i anijes ‘Libra’ do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve luftarake të Forcës Detare shqiptare, do të mundësojë përfshirjen e forcave ajrore në operacionet tona detare. Për efektivët e Forcës sonë Detare, kjo anije do të rikthejë mendësinë e operimit të anijeve me kapacitete ushtarake”, - u shpreh ministri Vengu.

Nga ana e tij, ministri italian i Mbrojtjes, Guido Crosetto deklaroi se Italia dhe Shqipëria do të forcojnë më tej bashkëpunimin e shkëlqyer që ekziston në të gjitha fushat, veçanërisht në mbrojtje. Në fjalën e tij, pas nënshkrimit të marrëveshjes, ministri Crosetto tha se: “...Ky i sotmi është një moment i rëndësishëm për ne, sepse është dëshmi konkrete e Italisë ndaj Shqipërisë dhe shpreh gatishmërinë dhe vullnetin tonë të mirë për të bashkëpunuar me Shqipërinë sa i përket mbrojtjes dhe çështjeve me karakter ekonomik.

Dhurimi i anijes ‘Libra’, sikurse e tha më parë ministri Vengu, është një pikënisje e një bashkëpunimi gjithnjë e më të fortë që ekziston mes vendeve tona. Gjithashtu edhe të bashkëpunimit mes Forcave tona të Armatosura dhe të gjithë sistemit industrial”.

Ministri italian u shpreh se: “Jetojmë në kohë të vështira ndaj kombet duhet të ndërgjegjësohen që duhet të bashkëpunojnë më ngushtë së bashku. Prej ditës së sotme ne do të rrisim nivelin tonë të bashkëpunimit, i cili nuk mund të bëjë gjë tjetër veçse të rritet dhe të forcohet më tej”.

Autonomia e anijes “Libra”, prej 3300 miljesh detare dhe shpejtësia prej 17 nyjash do të rrisin ndjeshëm aftësinë e Forcës Detare për të kryer operacione të ndërlikuara në distanca të mëdha dhe për periudha më të gjata kohore, pa varësi të madhe nga mbështetja logjistike.

Forca Detare, me anijen “Libra”, do të jetë e mundur që të kontribuojë më shumë në operacionet rajonale të sigurisë detare, siç është ajo e iniciativës ADRION, por gjithashtu do të mund të kontribuojë edhe në kuadër të Aleancës në operacionin “Focus Operations” (FOCOPS), pjesë e Operacionit “Sea Guardian”, jo vetëm me pjesëmarrje, por edhe duke e udhëhequr këtë operacion në Mesdheun Qendror.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve njerëzore të Forcave të Armatosura dhe rritëzimin e industrisë ushtarake të vendit, Akademia e Forcave të Armatosura dhe universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” nënshkruan tri marrëveshje bashkëpunimi.

Dokumentet e partneritetit u firmosën në prani të ministrit të Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, nga komandanti dhe rektori i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj dhe rektorja e Universitetit të Vlorës, prof. dr. Aurela Salaj. Këto marrëveshje parashikojnë: hapjen e programeve Master në Inxhinieri Armatimi, me profile në Aviacion dhe Detari, shkëmbimin e stafit akademik dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore.

Gjatë fjalës së tij, ministri Vengu theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi, në një kohë që Vlora pritet të marrë një hov të ri zhvillimi me rigjallërimin e inxhinierisë detare dhe hapjen e shkollës së aviacionit: “Arsyeja kryesore pse ne insistuam në këtë marrëveshje është e dyfishtë. E para, sepse Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes kanë nevojë të gjenerojnë kapacitete kombëtare që t’i shërbejnë vendit, jo vetëm për mbrojtjen dhe sigurinë e integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë, por edhe në kohë paqeje, si inxhinierë, ekspertë në fushën kibernetike, të armatimit, mbrojtjes civile, në menaxhimin dhe trajtimin e fatkeqësive natyrore, në fushën juridike, pse jo edhe specialitete të veçanta, ndaj na duhet të zgjerojmë gamën e formimit akademik dhe profesional të rekrutëve tanë”, - u shpreh ministri Vengu.

“Ne synojmë që me kapacitetet shkencore që kanë Akademia e FA-së dhe Universiteti i Vlorës të gjenerojmë njësi inovacioni në aviacion”, - sqaroi më tej, ministri Vengu, duke përmendur këtu kapacitetet që kërkohen me funksionimin e aeroportit të Vlorës. Sipas tij, ndikimi i këtij bashkëpunimi, nuk është vetëm në sigurinë kombëtare, por edhe në ekonomi.

“Jemi në kushtet e rigjenerimit të industrisë navale dhe nuk ka vend tjetër në Shqipëri, përveç

Bashkëpunimi i AFA-së me Universitetet: Një Projekt me Dimension Kombëtar për Arsimin dhe Inovacionin



se në Pashaliman. I duhen FA-së inxhinierë navalë, qoftë edhe për efekt të mirëmbajtjes së mjeteve ekzistuese dhe atyre që do të marrim në të ardhmen, sikundër i duhen ekonomistë tonë inxhinierë navalë, për të mbështetur aktivitetin e mirëmbajtjes së skafeve që shumohen për efekt të turizmit ndërkombëtar në vendin tonë, qoftë për prodhimin e mjeteve të reja, bazuar në marrëveshjen me qeverinë italiane”, - theksoi ministri Vengu. Gjatë diskutimit me pedagogë e studentë të Universitetit të Vlorës, ministri Vengu theksoi se, zhvillimi i kapaciteteve ushtarake duhet të ecë paralelisht me ato civile, ndaj kjo marrëveshje është një mundësi e artë për të rinjtë e Universitetit të Vlorës dhe Akademisë së FA, që do të kontribuojë në ringritjen e industrisë ushtarake shqiptare. Bashkëpunimi i Akademisë së FA do të shtrihet edhe në universitete të tjera të vendit për t’i dhënë një dimension kombëtar këtij projekti.

Ministri Vengu priti përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë: Bashkëpunim me BE-në për rigjallërimin e Industrisë së Mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu priti një takim të veçantë me përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, njëherësh zëvendës presidente e Komisionit Evropian, znj. Kaja Kallas. Bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes ishte në qendër të bisedës mes znj. Kallas dhe ministrit Vengu.

Z. Vengu përsëriti qëndrimin e pandryshuar të Shqipërisë për të qëndruar krah partnerëve të saj evropianë në mbrojtje të paqes dhe sigurisë në kontinentin evropian. Ministri Vengu theksoi se Shqipëria është e ndërgjegjshme për rëndësinë e lëvizshmërisë ushtarake dhe për këtë po investon në infrastrukturë dhe kapacitete përgjatë Korridorit VIII, duke filluar nga kompleksi Durrës/Porto Romano.

Ministri Vengu theksoi gjatë bisedës me përfaqësuesen e Lartë të BE-së, se Shqipëria ndjek një politikë rajonale konstruktive,



të bazuar në parimet e bashkëpunimit drejt proceseve integruese evropiane dhe euroatlantike dhe fqinjësisë së mirë.

Ndër të tjera, ministri Vengu shprehu përkushtimin për përfundimin e negociatave, për sa i përket grup-kapitullit të gjashtë, brenda vitit 2025.

Ministri Vengu e falënderoi zëvendës presidenten e KE-së për mbështetjen e dhënë për Forcat e Armatosura, mbështetjen, e cila do të vijojë.

Po ashtu, ministri Vengu e njohu znj. Kallas me hapat e hedhur drejt rijetëzimit të Industrisë së Mbrojtjes, me qëllim prodhimin e artikujve të mbrojtjes “Made in Albania”. Ministri Vengu i tha znj. Kallas se pala shqiptare është e interesuar të punojë me Bashkimin Evropian në këtë fushë, duke patur mundësi për akses të plotë në instrumentet financiare të BE-së për sigurinë dhe mbrojtjen.

Ministri Vengu në Takimin e Parë të Dialogut BE – Shqipëri për Sigurinë dhe Mbrojtjen: Forcojmë aftësitë mbrojtëse, për një rajon më të sigurt

Shqipëria do të intensifikojë bashkëpunimin dhe ndërveprimin me Bashkimin Evropian për të forcuar aftësitë mbrojtëse. Deklarata u bë nga ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, gjatë Takimit të Parë të Dialogut BE - Shqipëri për Sigurinë dhe Mbrojtjen, që u mbajt në Tiranë, me pjesëmarrjen e përfaqësueses së Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, njëherësh zëvendës presidente e Komisionit Evropian, znj. Kaja Kallas, e cila viziton për herë të parë Tiranën, në kuadër të një turi ballkanik.

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi se: “Partneriteti i ri i Sigurisë dhe Mbrojtjes ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së dhe ky dialog i parë duhet parë si bazë për një ‘qasje strategjike’ në rrugën e Shqipërisë drejt integritit të plotë në politikën, axhendën, instrumentet dhe mekanizmat përkatës të BE-së për Sigurinë dhe Mbrojtjen, madje edhe përpara anëtarësimit të plotë zyrtar. Ne duhet të vendosim qartë një nivel të përbashkët ambicie për të ndjekur qëllimin e përbashkët për të pasur një mbrojtje shumë më të fortë të BE-së, për të qenë e aftë të trajtojmë kërcënimet dhe sfidat tradicionale të sigurisë dhe ato në zhvillim, të cilat, siç e dimë të gjithë, kanë qenë masive vitet e fundit”. Ministri i Mbrojtjes u zotua për rritjen e kontributit të Shqipërisë në misionet për menaxhimin e krizave të drejtuara nga BE, nëpërmjet Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP), si EUPOR ALTHEA në Bosnje, EU Battle Groups dhe së shpejti operacionin detar ASPIDES.



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Kush është Drejtori i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, që prej një dekade drejton këtë institucion?

Prof. asoc. dr. Teki Ali Kurti ka lindur në fshatin Gjon të Martaneshit, më 25 prill 1966. Është diplomuar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Në vitet 2000-2006 ka qenë për dy mandate rresht i zgjedhur si kryetar në organet e qeverisjes vendore. Në vitin 2005 mori gradën shkencore “Master” në fushën e historisë, me temën “Mbi strukturën kushtetuese dhe veprimtaritë institucionale të Republikës së Italisë dhe të Republikës së Shqipërisë”. Në vitin 2010 mori gradën shkencore “Doktor” në fushën e historisë, pranë Universitetit të Tiranës, ku mbrojti temën “Institucionet dhe Qeverisja Vendore në Shqipëri 1912-1939”. Në vitin 2014 mori titullin “Profesor i Asociuar” pranë Universitetit të Tiranës.

Në vitin 2007 ka përfunduar studimet pasuniversitare pranë Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, e hapur në Shqipëri me mbështetjen e Këshillit të Europës. Po në këtë vit ka kryer kursin për Demokraci në Strasburg-Francë, drejtuar nga Terry Davis, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Nga viti 2007 e në vazhdim është lektor i jashtëm pranë Universitetit të Tiranës dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Gjithashtu është lektor në shkolla e universitete private, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Është autor i disa botimeve në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është kryetar i Bordit të revistës “Buletini Arkivor Ushtarak”, Botim i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura. Ka organizuar dhe drejtuar dy konferenca shkencore për trevën e Martaneshit, në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe ka realizuar një dokumentar për këtë trevë.

Aktualisht kryen detyrën e Drejtorit të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes. Është anëtar i Këshillit të Lartë të Arkivave të Republikës së Shqipërisë dhe anëtar i Asamblesë së Institutit Shqiptar të Sociologjisë.

Drejtor, mund të na bëni një përmbledhje të shkurtër të historikut të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura?

Baza për krijimin e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, ishin dokumentet me karakter ushtarak të hartuara nga formacionet politike dhe ushtarake të vendit gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe ato të veprimtarisë së Forcave të Armatosura Shqiptare në dy dekadat e para të pasçlirimit.

Në ditën e Çlirimit të Tiranës, më 17 nëntor 1944, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me një urdhër dërguar Korparmatës, kërkoi krijimin e një komisioni, ku do të merrte pjesë një anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, që do të merrte në dorëzim të gjitha dokumentet zyrtare të shtetit shqiptar, të ministrive, të bashkive, të kuesturave, të ushtrisë kuislinge, të cilat do të administroheshin prej Forcave të Armatosura. Këto dokumente përbënin bazën e krijimit të fondit arkivor kombëtar dhe, më pas, të krijimit të institucioneve që do të merreshin me pasurimin, sistemimin, ruajtjen dhe vënien në shfrytëzim të këtyre dokumenteve. Këtë veprimtari para-arkivore, Forcat e Armatosura e ushtruan deri në vitin 1949, ku me Vendim të Këshillit të Ministrave, u krijua Arkivi Qendror i Shtetit.

Këtij arkivi iu ngarkua misioni të grumbullonte dokumente nga lashtësia deri në vitin 1944, si dhe dokumente të institucioneve në veprim, që mbushnin 20 vjet nga data e Çlirimit të vendit (nëntor 1944), të institucioneve që pushonin veprimtarinë e tyre dhe nuk vazhdonin të ushtronin këtë veprimtari në një institucion tjetër, të personave publikë me rëndësi (pas vdekjes së tyre) dhe të dokumenteve që flisnin për historinë e vendit tonë që ndodheshin jashtë vendit.

Në vitin 1961, me Vendim të Këshillit të Ministrave

PA ARKIV NUK KA HISTORI, PA HISTORI NUK KA KOMB



Nr. 109, datë 21.04.1961, në kuadër të “Riorganizimit të Arkivave Shtetërore”, në Ministrinë e Mbrojtjes organizohet Arkiva e Përkohshme.

Më Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 89, dt. 21.03.1964 u zyrtarizua për herë të parë si institucion më vete Arkivi i Ministrisë së Mbrojtjes, me vendndodhje në Ministrinë e Mbrojtjes së asaj kohe.

Në vitin 1983, Arkivi Qendror i Ushtrisë (AQU) del institucion autonom në varësi të Ministrit të Mbrojtjes. Ndërsa në vitin 1994, Arkivi Qendror i Ushtrisë (AQU) transferohet nga godina në zonën e Ali Demit në garnizonin e shkollës së lartë të bashkuar të oficerëve “Skënderbej”, ku ndodhet edhe sot. Në viti 1999 emërtohet Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, emër që e mban aktualisht.

Cili është organizmi i AQFA-së sot?

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura ka në strukturë 8 (tetë) sektorë, si më poshtë:

- Sektori i Ruajtjes dhe Administrimit të Dokumenteve
- Sektori i Dokumenteve të Klasifikuara
- Sektori i Përpunimit të Dokumenteve
- Sektori i Komunikimit dhe Shfrytëzimit të Dokumenteve
- Sektori i Digjitalizimit, Restaurimit dhe Fototeka
- Sektori i Inspektimit dhe Trajnimeve
- Sektori i Sekretarisë dhe Arkivit
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve

Arkivi ka një personel të kualifikuar prej 26 (njëzet e gjashtë) punonjësish.

Cili është misioni i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura?

Misioni kryesor i AQFA-së është pranimi, ruajtja, administrimi, përpunimi tekniko-shkencor dhe vënia në shfrytëzim, për interesa studimore a private, të dokumenteve që janë krijuar e krijohen gjatë veprimtarisë në rrjetin arkivor të FA-së, të cilat shpallen me rëndësi historike kombëtare. Njëkohësisht AQFA-ja kontrollon zbatimin e Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe jep ndihmë metodike në sekretari, sekretari-arkiva e arkivat e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, komandave, njësive, reparteve dhe institucioneve në vartësi të tyre.

Gjatë periudhës Tuaj si drejtues i AQFA-së, cilat kanë qenë disa nga arritjet kryesore?

Deklasifikimi i dokumenteve

Për të herë të parë është kryer procesi i deklasifikimit masiv të dokumenteve që përmbajnë informacion të klasifikuar, si më poshtë: Dokumente të personel-organizimit, 1945-1993, dokumente të arsimit ushtarak, 1945-1993, dokumente të degëve ushtarake për 28 rrethe, dokumente teknike të hartografisë ushtarake, deklasifikim periodik sipas kërkesave të veçanta të paraqitura nga institucione shtetërore dhe publike; Fondi i Komitetit

Qendror të PPSH-së, Drejtoria Politike, dokumente të informacionit të klasifikuar, niveli “tepër rezervat”, “rezervat”, “tepër sekret” dhe “sekret”, për vitet 1946-1974. Gjithsej 2172 dosje: Informacioni i klasifikuar, prodhuar nga komitetet e partisë në ushtri, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, komandat, njësitë, repartet dhe institucionet në varësi të tyre, për titullim, gradim, emërim, transferim, lëvizje, vënie në dispozicion, dalje në rezervë, dalje në lirim, dalje në pension, dalje në asistencë të kuadrit oficerë, nënoficerë, rezervistë dhe punonjës civilë; Dokumente nga Fondi i Sekretariatit, (Sektori i Përgjithshëm), Shtabi i Përgjithshëm, Drejtorisë Operative dhe Stërvitjes, Drejtorisë së Organizim Mobilizimit vitet 1954-1994.

Në zbatim të VKM nr. 487, datë 17.10.1994, “Për kalimin e Fondit Arkivor të Këshillit të Mbrojtjes nga Arkivi i Shtetit te Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura”, pas 26 vitesh, në vitin 2020, më nismën e AQFA, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, ky fond u bë pjesë e fondeve të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura.

Këto dokumente tashmë janë të hapura, në dispozicion të studiuesve si dhe studenteve të masterit e doktoraturës.

Puna për deklasifikim vazhdon dhe sot, ku është përgatitur bibliografia e të gjithë fondeve arkivore të drejtorive të Ministrisë së Mbrojtjes të dokumenteve të klasifikuar “Sekret shtetëror” përpara vitit 1991, të cilat priten të kalojnë në Komisionin e Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit.



Shërbimi arkivor

Në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit, shërbimit arkivor, transparencës dhe anti-korrupsionit, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (AQFA) ka shërbyer dokumente sipas kërkesave: të qytetarëve (ushtarakë aktivë, ish-ushtarakë e punonjës civilë të FA-së), të Qendrës së Personel Rekrutimit (për plotësimin e dosjeve të ushtarakëve dhe për efekt llogaritje të përfitimeve për dalje në pension), të studiuesve (vendas dhe të huaj) apo institucione të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe është punuar për përmirësimin e shërbimit arkivor, duke ofruar publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes (online) të të gjitha shërbimeve dhe tarifave përkatëse.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 153, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 1.1.2020”, Arkivi Qendror i FA-së



ka filluar implementimin e 17 shërbimeve online në platformën e-Albania nëpërmjet dy sistemeve SQDNE (Sistem shkëmbimi kërkesë-përgjigje midis AQFA dhe institucioneve) dhe AMS (Sistem shkëmbimi kërkesë-përgjigje midis AQFA dhe çdo qytetari). Çdo qytetar apo institucion mund t'i drejtohet për informacion elektronikisht AQFA-së në lidhje me 17 shërbimet e listuara në sistem dhe të marrë përgjigje brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj.

17 shërbimet që ofron AQFA janë këto:

1. Aplikim për dokumente të ushtrive të huaja në Shqipëri.
2. Aplikim për dokumente të veprimtarisë politike të partisë shtet në FA.
3. Aplikim për dokumente të veprimtarisë së brigadave, komandave dhe divizioneve partizane.
4. Aplikim për fotokopje dokumentesh të fondeve arkivore për efekt studimi ose botim, si dhe shërbimi të kuadrit ushtarak dhe civil në Forcat e Armatosura.
5. Aplikim për fotokopje dokumentesh të karakterit historik për krijimin, veprimtarinë dhe suprimimin e strukturave të Forcave të Armatosura.
6. Aplikim për manuale dhe rregullore të veprimtarisë ushtarake në FA.
7. Aplikim për shtypin ushtarak.
8. Fotokopje dokumentesh mbi gradime, titullime, emërimë, transferime dhe largime nga detyra të personelit ushtarak dhe civil në FA.
9. Fotokopje dokumentesh mbi kryerjen e shërbimit ushtarak.
10. Fotokopje dokumentesh për dërgim me shërbim, studime, kualifikim jashtë vendit.
11. Fotokopje dokumentesh për përfitime strehimi dhe dokumente teknike të objekteve ushtarake.
12. Fotokopje dokumentesh për të dhëna nga dosjet personale për ushtarakët në FA, para vitit 1971.
13. Fotokopje dokumentesh teknike (gentplane, planimetri, etj.) për repartet dhe objektet ushtarake.
14. Fotokopje të programeve mësimore të shkollave të larta ushtarake.
15. Kartonë evidence për të dhëna personale të oficerëve rezervistë.
16. Vërtetim dhe lista notash përkryerjen e studimeve në shkollat ushtarake.
17. Vërtetime për ngjarje të jashtëzakonshme të ndodhura në FA.

Në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat, i ndryshuar me ligjin 27/2024, në nenin 29”, përcaktohet se Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura kalon në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, duke sjellë që shërbimi online i ofruar nga AQFA, nga data 1 janar 2025, ka kaluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, ku deri më sot për shkak të periudhës tranzitore të kalimit, AQFA po bashkëpunon me DPA-në për kthimin e përgjigjeve për të qenë sa më korrekt me institucionet dhe qytetarët.

Administrimi i dokumenteve

Sot Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura disponon rreth 537 fonde arkivore, ku totali i dokumenteve

është afërsisht 4,630 m/l, ku përfshihen fonde arkivore administrative dhe të klasifikuara, gjithashtu Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura administron 326 copë flamuj luftarak, 3735 fletë harta topografike të paplotësuara, si dhe në sektorin e Digjitalizimit, Restaurimit dhe Fototekës administrohen 2219 bobina, 249 shirita incizimi, 12 copë filma rikuanicione, 28,788 copë foto digjitale, 28,503 foto letër, dhe 56 copë albume.

Është kryer me urdhra të Ministrit të Mbrojtjes përthithja e dokumenteve të reparteve të suprimuara ndër vite, të cilat rrezikonin zhdukjen fizike. Ndër më kryesoret janë: Komanda e Forcës Tokësore, Forcës Detare, Mbështetëse, e Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe



Reparteve Ushtarake Nr. 6630, dhe Nr. 6640 kanë dorëzuar dokumentet e ish - Reparteve Ushtarake, ku janë përthithur afërsisht 238 m/l.

Janë marrë në administrim dokumente me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), të Qendrës së Radio Zbulimit (Reparti Ushtarak Nr. 6614, 5555), për vitet 2008 - 2009 dhe Sekretarisë së AQFA-së (Reparti Ushtarak Nr. 6622,4407) për vitet 2004-2010, të cilat i shtohen fondeve arkivore me 233 dosje.

Një gjë që është për t'u evidentuar, në AQFA është përthithur për herë të parë, pas gati 80 vitesh, lënda arkivore në fotografi dhe video nga njësitë e repartet e Forcave të Armatosura bazuar në ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe janë bërë pjesë e Arkivit Qendror të FA-së, si më poshtë:

- Foto digjitale, gjithsej 29.071 foto.
- Video digjitale me USB dhe DVD, gjithsej 90 video.
- Kasketa VHS, gjithsej 29 kaseta.

• Foto nga veprimtari të ndryshme të Forcave të Armatosura, gjithsej 20.102 foto.

Cilat kanë qenë aktivitetet dhe bashkëpunimet më të rëndësishme të kryera ndër vite?

- Botimi periodik i Buletinit Arkivor Ushtarak; ekspozitë me dokumente arkivore në raste përvjetorësh të FA-së;
- Vizitë pune nga ekipi i arkivave të Forcave të Armatosura Turke dhe të Emirateve të Bashkuara Arabe;
- Marrëveshje për bashkëpunim në fushën e botimeve dhe shfrytëzimin e fondeve arkivore. Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura dhe Instituti i Akademisë së Studimeve Albanologjike lidhën marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre me qëllim nxitjen e kërkimit shkencor në fushën e studimeve albanologjike, me fokus studimet historike të Shqipërisë dhe Kosovës, si prioritete kyçe për të dy institucionet.
- Pjesëmarrës si përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes në takimin ndërinstitutional, me qëllim njohjen dhe plotësim e dokumentacionit hartografik, për periudhën 1934-1942 të Republikës së Shqipërisë, në Institutin Gjeografik Ushtarak të Firences, Itali.

• Vizita të studentëve të nivelit master të degës së Historisë, Universiteti i Tiranës;

• Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe me strukturat e Forcave të Armatosura për metodologjinë e punës me dokumentet, si dhe kualifikimin e personelit;

• Bashkëpunim me drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore të qarqeve, për shërbimin arkivor të dokumenteve të kërkuara, për ushtarakët e punonjësit civilë të FA-së, si dhe për dorëzimin pranë këtyre drejtorive të gjithë listëpagesave që gjendeshin në fondet arkivore, të cilat kaluan në procesin e inventarizimit.

• Ekspozitë fotografike dhe dokumentare me rastin e 60-vjetorit të krijimit të AQFA-së, 80-vjetorin e Çlirimit të Atdheut, 25-vjetorit të Çlirimit të Kosovës dhe 15-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

Ç’punë është bërë për digjitalizimin e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura? Cilat janë planet për të ardhmen?

Në përmbushje të misionit të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura janë vendosur prioritete dhe janë hartuar kërkesat për projekte të investimeve për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Inovacionit dhe Automatizimit në Ministrinë e Mbrojtjes u arrit miratimi i projektit “Sistemi i digjitalizimit të fondeve të arkivore”. Sot janë vënë në përdorim pajisjet elektronike dhe linja e internetit në sektorin e informacionit, për implementimin e shërbimeve arkivore online në portalin e-Albania nëpërmjet “Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me nënshkrim Elektronik”.

Prioritet i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, në përmbushje të misionit të tij, dhe rritjes së cilësisë së shërbimit arkivor ndaj publikut, mbetet zbatimi i projektit “Sistemi i digjitalizimit të fondeve të arkivore”.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2024”, janë ndjekur procedurat për Planifikimin Buxhetor Afatmesëm për shpenzimet operative dhe prioritetit të projekteve për investime, ku Arkivi Qendror i janë përcaktuar fondet për “Digjitalizimin e Dokumenteve Arkivore”, si më poshtë:

- Për vitin 2024: 68,392,000 lekë
- Për vitin 2025: 137,568,000 lekë
- Për vitin 2026: 137,568,000 lekë

Për shkak të ndryshimeve në ligjin “për Arkivat”, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura ka kaluar në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, ku është strukturuar në një sektor të kësaj drejtorie me emërtesën “Sektori i Forcave të Armatosura”, të cilët do të administrojnë të gjithë dokumentacionin e administruar më parë nga AQFA, përveç dokumenteve teknike të tipologjisë së veçantë të armatimit, pajisjeve teknologjike ushtarake të Forcave të Armatosura, të cilat mendohet se do të administrohen nga Arkivi Qendror në Veprim, ku Ministri i Mbrojtjes po jep mbështetjen maksimale për krijimin e këtij arkivi.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

E drejta e votës është një e drejtë themelore demokratike, që u lejon qytetarëve të ndikojnë në qeverisjen dhe vendimmarrjen politike të vendit të tyre. Në shumicën e vendeve demokratike, vota është një e drejtë dhe një përgjegjësi e qytetarëve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre dhe për të ndikuar në politikat publike.

Pse duhet të votojmë?

Për të ndikuar në të ardhmen tonë: Vota jonë ndihmon në zgjedhjen e liderëve dhe politikave që do të ndikojnë në të ardhmen e brezave.

Është një e drejtë dhe një detyrim qytetar: Shumë njerëz në histori kanë luftuar për të fituar të drejtën e votës, dhe pjesëmarrja në zgjedhje është një mënyrë për të nderuar këtë të drejtë.

Ndikon në vendimmarrjen politike: Çdo votë ka rëndësi dhe mund të ndikojë në drejtimin e politikave qeveritare për çështje si arsimi, shëndetësia, ekonomia dhe të drejtat sociale.

Për të forcuar demokracinë: Sa më shumë njerëz të marrin pjesë në votime, aq më përfaqësuese dhe e fuqishme bëhet demokracia.

Për të zgjedhur përfaqësuesit më të mirë: Nëse nuk votojmë, të tjerët do të vendosin për ne, dhe mund të mos zgjidhen njerëzit apo politikat që ne mbështesim.

Pra, votimi është një nga mënyrat më të mira për të marrë pjesë aktive në shoqëri dhe për të ndikuar në mënyrën se si qeveriset vendi.

Historia e votimit në Shqipëri ka kaluar nëpër faza të ndryshme, të ndikuara nga regjimet politike dhe zhvillimet shoqërore.

Votimi në periudhën e mbretërisë (1920-1939)

Në vitet 1920-1939, Shqipëria kishte një sistem parlamentar me zgjedhje të kufizuara. Gjatë Mbretërisë së Zogut, zgjedhjet nuk ishin plotësisht të lira, pasi mbreti kishte ndikim të madh mbi procesin zgjedhor.

Votimi në periudhën komuniste (1945-1990)

Gjatë regjimit komunist, Shqipëria kishte një sistem votimi të kontrolluar nga Partia e Punës. Votimet ishin të detyrueshme dhe të manipuluara, ku qytetarët kishin vetëm një listë kandidatësh të miratuar nga partia.

Rezultatet shpalleshin me mbi 99% të votave pro për kandidatët e partisë, duke krijuar një sistem ku votimi ishte më shumë formalitet sesa një zgjedhje e vërtetë. Në këtë periudhë, votimi prodhonte një legjitimitet të rremë për regjimin, duke mos reflektuar vullnetin e vërtetë të qytetarëve.

Votimi pas rënies së komunizmit

(1991 e në vazhdim)

Zgjedhjet e para pluraliste u mbajtën në vitin 1991, ku qytetarët për herë të parë pas dekadash kishin mundësi të zgjedhin midis partive të ndryshme.

Procesi zgjedhor fillimisht u shoqërua me probleme si manipulime, blerje votash dhe presion politik.

Me kalimin e viteve, sistemi zgjedhor është përmirësuar, por akoma përballlet me sfida si korrupsioni dhe ndërhyrjet politike.

Çfarë prodhonte ky votim?

Në komunizëm: Votimi prodhonte një qeverisje moniste dhe një legjitimitet artificial për regjimin. Pas



Vota, forca që formëson të ardhmen

vitit 1991: Votimi ka prodhuar qeveri të ndryshme, por edhe kriza politike, pasi shpesh zgjedhjet janë kontestuar nga partitë politike.

Në përgjithësi, ndërsa votimi sot është më i lirë dhe më demokratik, sfida kryesore mbetet garantimi i zgjedhjeve të ndershme dhe transparencë e procesit zgjedhor.

Shqiptarët kanë treguar nivele të ndryshme të qytetarisë në procesin zgjedhor, duke reflektuar një përzierje të angazhimit demokratik, apatisë dhe sfidave të sistemit.

Disa nga aspektet kryesore të sjelljes qytetare të shqiptarëve në zgjedhje parë nga këndvështrimi im, rritur mes dy sistemesh atij totalitar dhe demokratik:

Pjesëmarrja në zgjedhje

Pjesëmarrja mesatare në zgjedhje varion nga 40% në 55%, por shpesh ka qenë më e ulët se në vendet e tjera evropiane.

Në zgjedhjet e para pluraliste (1991-1992), pjesëmarrja ishte shumë e lartë, por ka rënë me kalimin e viteve për shkak të zhgënjimit me politikën.

Pjesëmarrja është më e lartë në zgjedhjet parlamentare, ndërsa në zgjedhjet lokale shpesh është më e ulët.

Angazhimi qytetar në fushata dhe debatin politik

Interesi për politikën - Shqiptarët janë shumë të angazhuar në debatet politike dhe diskutojnë politikën në jetën e përditshme (familje, kafe, rrjete sociale).

Ndikimi i militantizmit - Shumë votues mbeten të lidhur fort pas partive të tyre tradicionale dhe nuk i analizojnë premtimet politike objektivisht.

Ndërgjegjësimi dhe votimi i lirë

Përmirësimi në transparencë - Me rritjen e teknologjisë dhe mediave, ka më shumë ndërgjegjësim mbi të drejtat zgjedhore dhe procesin e votimit.

Problemet me blerjen e votës – Fenomeni i shitblerjes së votës dhe presionit politik është një sfidë serioze që dëmton qytetarinë zgjedhore.

Respektimi i rregullave të votimit

Në përgjithësi, procesi i votimit është i qetë, dhe shumica e qytetarëve e respektojnë.

Incidentet zgjedhore - Ka raste të manipulimit të votave, probleme me administrimin e zgjedhjeve dhe kontestime të rezultateve.

Shqiptarët kanë një angazhim të fortë politik, por pjesëmarrja e tyre në votime nuk është gjithmonë në nivele



SHQIPTARËT KANË NJË ANGAZHIM TË FORTË POLITIK, POR PJESËMARRJA E TYRE NË VOTIME NUK ËSHTË GJITHMONË NË NIVELE TË LARTA. PROBLEMET SI BLERJA E VOTËS, APATIA POLITIKE DHE MUNGESA E BESIMIT NË INSTITUCIONE, PENGOJNË ZHVILLIMIN E NJË KULTURE TË PLOTË DEMOKRATIKE. PËR TË RRIUR QYTETARINË NË ZGJEDHJE, NEVOJITEN REFORMA MË TË FORTA, EDUKIM POLITIK DHE TRANSPARENCË MË E MADHE NË PROCESIN ZGJEDHOR.

të larta. Problemet si blerja e votës, apatia politike dhe mungesa e besimit në institucione, pengojnë zhvillimin e një kulture të plotë demokratike. Për të rritur qytetarinë në zgjedhje, nevojiten reforma më të forta, edukim politik dhe transparencë më e madhe në procesin zgjedhor.

Më 11 maj 2025, shqiptarët do të votojnë në zgjedhjet parlamentare të caktuara nga Presidenti i Republikës z. Bajram Begaj.

Një aspekt i rëndësishëm i këtyre zgjedhjeve është përfshirja e votuesve nga diaspora, duke synuar një pjesëmarrje më të gjerë të qytetarëve që jetojnë jashtë vendit.

Çfarë presim pas 11 majit?

Pas zgjedhjeve të 11 majit, priten disa zhvillime kyçe:

- **Formimi i Qeverisë së Re:** Në varësi të rezultateve, partia ose koalicioni fitues do të mandatohet për të formuar qeverinë e re, duke përcaktuar drejtimin politik dhe ekzekutiv të vendit për mandatin e ardhshëm.

- **Implementimi i Politikave të Premtuara:** Partitë politike kanë prezantuar platforma dhe premtime gjatë fushatës. Pas zgjedhjeve, pritet që fituesit të fillojnë zbatimin e këtyre politikave, duke u fokusuar në çështje

si ekonomia, integrimi evropian, shëndetësia dhe arsimi.

- **Analiza e Pjesëmarrjes dhe Rezultateve:** Pas përfundimit të procesit zgjedhor, institucionet dhe analistët do të vlerësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve, veçanërisht të votuesve për herë të parë dhe atyre nga diaspora, për të kuptuar ndikimin e tyre në rezultatet zgjedhore.

- Është thelbësore që qytetarët të ndjekin me vëmendje zhvillimet pas-zgjedhore dhe të mbajnë të informuar për hapat e ardhshëm të qeverisë së re, duke u angazhuar aktivisht në proceset demokratike të vendit.

Të rinjtë që votojnë për herë të parë përjetojnë një përzierje emocionesh, duke filluar nga entuziazmi dhe krenaria, deri te pasiguria dhe skepticizmi. Ky moment është i veçantë, pasi për shumë prej tyre shënon hyrjen në botën e të rriturve dhe në angazhimin aktiv qytetar.

Shumë të rinj ndihen të emocionuar, sepse për herë të parë po marrin pjesë në një proces demokratik që ndikon në të ardhmen e vendit të tyre. Ata e shohin këtë si një përgjegjësi dhe një mundësi për të shprehur mendimin e tyre. Votimi është një akt që simbolizon pavarësinë dhe pjekurinë. Për herë të parë, ata ndihen të fuqizuar që zëri i tyre ka vlerë në vendimarrje.

Disa të rinj mund të ndihen të pasigurt për këtë të votojnë,

ose për procesin e votimit, veçanërisht nëse nuk kanë marrë informacion të mjaftueshëm. Ata mund të ndiejnë presion nga familja, miqtë ose grupet politike.

Një pjesë e të rinjve ndihen të zhgënjyer me politikën dhe mund të shohin votimin si një akt simbolik që nuk sjell ndryshime të mëdha. Kjo ndjenjë mund t'i bëjë disa prej tyre të mos votojnë fare.

Disa të rinj hyjnë në proces me një mendje të hapur dhe shohin votimin si një mundësi për të kuptuar më mirë politikën dhe demokracinë.

Në fund të fundit, emocioni i të rinjve kur votojnë për herë të parë është një përzierje e fuqishme mes shpresës dhe përgjegjësisë. Sa më shumë informim dhe ndërgjegjësim të kenë, aq më i rëndësishëm dhe kuptimplotë do të jetë ky moment për ta.

Shpresa dhe optimizmi për fillimin e një dite të re

Mëngjesi pas votimit shënon përfundimin e një procesi demokratik dhe fillimin e një etape të re. Dielli që lind mbi qytet përfaqëson dritën e një të ardhmeje të ndritur, të mbështetur në vullnetin e popullit. Në këtë moment, njerëzit shpresojnë që zgjedhja e tyre të sjellë ndryshimet e dëshiruara dhe një jetë më të mirë për të gjithë.

Përgjegjësia qytetare

Votimi nuk është vetëm një akt i një dite të vetme; ai përcakton rrjedhën e zhvillimeve për vitet e ardhshme. Mëngjesi pas votimit është një kujtesë se çdo votë ka peshë dhe se demokracia funksionon vetëm kur qytetarët marrin pjesë aktivisht. Kutia e votimit në plan të parë simbolizon këtë përgjegjësi të madhe, duke na kujtuar se e ardhmja ndërtohet nga vendimet që marrim sot.

Ndikimi i zgjedhjeve

Pas votimit, qytetarët presin rezultatet dhe ndikimin që ato do të kenë në jetën e tyre. Në këtë periudhë të pritjes, ka një ndjenjë pasigurie, por edhe besimi se sistemi demokratik do të reflektojë vullnetin e shumicës.

Një Dite të Re

Një ditë e re nuk është vetëm një ndryshim kalendarik, por një mundësi për një fillim të ri politik, ekonomik dhe shoqëror. Ndërsa qyteti zgjohet dhe vazhdon jetën e tij, në mendjet e njerëzve mbetet pyetja: A do të sjellë kjo ditë ndryshimin që dëshiroam?



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Kujtohuni për poetët ushtarakë

Një telefonatë e vonë nga shkrimtari dhe poeti Pandeli Koçi, u bë shkak për këtë shkrim rreth poetëve ushtarakë në vite. Ata janë shumë, u rritën dhe frymëzuan njëri-tjetrin në shkollat ushtarake. Të shfletosh libra e gazeta, do të ndeshesh me mjaft poetë ushtarakë, që në vite derdhën shpirtin e tyre në vargje, duke i kënduar Atdheut, heronjve, dëshmorëve, patriotëve, ndjenjës kombëtare... Poetë ushtarakë janë një armatë, shumë... Lirim Deda, Hysni Milloshi, Halil Qendro, Hamza Koçi, Iliriana Sulkuqi, Bexhet Çerma, Çobo Skëndi, Vëllezërit Duka, Vëllezërit Anastasi dhe mjaft të tjerë.

Pandeli Koçi vijon telefonatën, duke më thënë se librat e parë me poezi të autorëve që kam redaktuar janë: Myslim Pasha, Stefan Martiko, Fluturak Gërmenji, Kujtim Halili, Vangjel Leka, Milianov Kallupi, Kolë Ndreka, Demokrat Anastasi, Julia Naçi... dhe vazhdon... një armatë e derdhur në vargje, në tregime, novela e romane etj.

Veç shkrimeve për këta autorë ushtarakë, më sugjeroi që nga Ministria e Mbrojtjes nuk është realizuar kurrë botimi i një libri me poezi të autorëve ushtarakë. Po e nis shkrimin thjeshtë, me disa prej tyre, kjo si një kujtesë për rrugëtimin e tyre në jetë...

Poeti i atdhedashurisë

Poeti, novelisti, shkrimtari dhe publicisti Lirim Dede ka lindur në Nivicë të Kurveleshit, më 16 shkurt 1936, dhe ka ndërruar jetë në Tiranë, 9 shtator 2016. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse shtatëvjeçaren dhe gjimnazin në shkollën Ushtarake “Skënderbej”. Mbaroi studimet për oficer dhe Universitetin e Tiranës, dega Gjuhë-Letërsi Shqipe. Në vitet 1961-1965 ka punuar si gazetar i kulturës në shtypin ushtarak dhe pastaj deri në vitin 1969 u dërgua për riedukim në Shkodër, Kukës, Tropojë. Rikthehet në shtypin ushtarak kryeredaktor i revistës “10 Korriku”, deri në vitin 1975, kohë kur filloi lufta me “fshehtësinë e hekurt” në ushtri: përjashtohet nga partia, shkarkohet nga detyra e kryeredaktorit, përjashtohet nga kolegji i gazetës “Drita” dhe nga Komiteti Drejtues i Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve, i hiqet e drejta e botimit si shkrimtar e gazetar, “transferohet” fillimisht në Dumre të Elbasanit e më pas në Sopot të Librazhdit në brigadat e punës, ku punoi deri në vitin 1990.

Me ardhjen e demokracisë e gjejmë redaktor në gazeta të ndryshme. Ruajti identitetin e tij. Ishte kryetar i degës së Lidhjes së shkrimtarëve e artistëve të Elbasanit. Që nga viti 2000 punon si kryeredaktor i gazetës “Labëria” dhe është anëtar i kryesisë së lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë.

Ka botuar këto vëllime poetike: “Këngët e marshimeve” (1966), “Miqve dhe armiqve” (1968), “E dua këtë tokë” (1970), “Kolana e poezisë së zgjedhur shqipe” (1970), “Tregimet e veriut” (1971), “2Zambakë nga Hanoi” (1972), “Kënga e fitimtarëve” (1973), “Shënime për shokët letrarë” (shënime kritike-1974), “Në vijën e patrullimit” (1969), “Baladë vietnameze” (reportazhe, 1979), “Në Kinën e madhe” (reportazhe, 1974), “Zëri i tokës” (1980), “Gjurmë të arta” (1995), “Eja të blesh zemrën time” (1996), “Rrufe pikëllimi” (1997), “Trëndafili i zi” (1998), “Bukuria të verboka” (1999), “Djepvarri im”, “Trimja Labëri” (2002), “Kush e vrau dashurinë” (shënime kritike-2006), autor i disa teksteve fituese të çmimeve të para të kënduara nga Vaçe Zela.

Iu përkushtua luftës partizane

Hysni Milloshi ka lindur në vitin 1948, në Macukull të Matit. Pas shkollës 8-vjeçare në vendlindje studioi në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej” dhe në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”. Pas diplomimit si oficer gjitharmësh, punon si sekretar i Komitetit të Rinisë në Korpusin e Shkodrës, ku fillon studimet me korrespondencë në “Luigj Gurakuqi”. Më pas dërgohet nga Ministria e Mbrojtjes për studime në Universitetin e Tiranës, ku kreu Fakultetin e Shkencave Juridiko-Politike. Për disa kohë drejtoi si kryeredaktor edhe gazetën “Studenti”. Ka punuar si gazetar dhe drejtues në organet e shtypit ushtarak, si dhe ka botuar shumë libra në prozë, poezi dhe dramë. Më 10 shtator 1991, drejton riorganizimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe zgjidhet kryetar i saj. Në zgjedhjet e 8 majit 2011, Hysni Milloshi kandidoi për kryetar të Bashkisë së Tiranës.

Hysni Milloshi ka ndërruar jetë, më 25 Prill 2012, në

POETËT USHTARAKË, VAZHDIET TË RILINDJES KOMBËTARE

Poetët ushtarakë, vazhduet të Rilindjes Kombëtare



Sanatoriumin e Tiranës, ku gjendej i shtruar për shkak të fibrozës pulmonare, nga e cila vuante prej kohësh.

Shkroi për patriotët korçarë

Përkushtimi i historianit Hamza Koçi, patriot korçar. Ende ka shumë për t’u thënë mbi figurat patriotike. Një pjesë e jetës së tyre ka mbetur e pathënë, ndërsa po tentohet të plotësohet nga historianët e Korçës. Këtë ka marrë përsipër historiani Hamza Koçi, përmes një ekspozite të hapur, e cila do të qëndrojë në dispozicion të qytetarëve të Korçës deri më 12 dhjetor. Koçi ka sjellë në këtë ekspozitë 50 patriotë të qarkut Korçë, duke filluar nga Naum Veqilharxhi, hartuesin e abetares së parë shqipe, Themistokli Gërmenjin, njeriu që bashkë me luftëtarë të tjerë i dha Korçës autonominë, për të vijuar me Fan Nolin, figurën e dimensioneve gjigante të kombit shqiptar, por edhe me figura të tjera si Thimi Mitko, Abedin Tuxhari, Pandeli Cale, Papa Kristo Negovani, Baba Hyseni i Melçanit etj. Hamza Koçi shpjegon, se kishte qenë një dëshirë e tij e hershme për të ekspozuar një enciklopedi të hapur mbi patriotët e qarkut të Korçës, të cilët vijnë nga trevat e Korçës, Kolonjës, Pogradecit dhe Devollit, me synimin për të prezantuar të pathënat e deritanishme për shumë nga patriotët korçarë... Në përpjekjet e historianit Koçi, për të prezantuar Rilindjen Kombëtare në të gjitha anët e saj, gjen rrugën nëpër të cilën u ringjall gjuha shqipe, deri në mbërritjen e saj si gjuhë letrare...

Gazeta “Telegraf” shkruan se u nda nga jeta poeti, ish-ushtaraku dhe intelektual i njohur Hamza Koçi, i cili në jetë mbeti një intelektual i singertë, një bashkëpunëtor i rrallë dhe korrekt, një atdhetar me vlera. Hamza ishte njeri i rrallë për shpirtin e tij, për këmbënguljen, për vizionin dhe rolin në shoqëri. Ai ishte gjithmonë kërkues, studiues, parashikues dhe i drejtpërdrejtë. “Telegraf” thekson se humbja e një njeriu që fjalën e mirë, fjalën e ëmbël e kishte përshëndetjen më të zakonshme. I papërtuar, dërgonte në redaksi me thjeshtësi shkrime të ndryshme me karakter social dhe patriotik. I heshtur dhe punë shumë, shkrimet e tij mbeten ndër më të lexuarit e lexuesve të gazetës sonë. Krijimtaria e tij ishte e gjithanshme dhe shumë e spikatur, me karakter të theksuar patriotik. Librat “Antologji poetike e heroizmit të madh” me bashkautor Hamza Koçin, Guri Pejo dhe “Portrete patriotësh të qarkut të Korçës”, vëllimi I, me autorë Albert Gora, Hamza Koçi, librin “Këngë për detin” me vjersha.

Të jesh grua...

Iliriana Kadri Sulkuqi (Fejzullai) u lind në qytetin e Elbasanit, në vitin 1951. Mbasi mbaroi gjimnazin “Dhaskal Todri” në qytetin e lindjes (1969), vazhdoi studimet në Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore në Tiranë. Është diplomuar në vitin 1971. Oficere në Akademinë Ushtarake, gazetarë në shtypin ushtarak dhe në Shtëpinë Botuese të Ushtrisë. Gjatë kësaj periudhe ka mbaruar studimet për gjuhë-letërsi dhe filozofi. Së fundi ka punuar si gazetarë në gazetën “Drita”, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë... Nga viti 2004 deri sot jeton në SHBA, New York.

Botimet e para, rreth viteve 1960. Është vlerësuar disa herë me çmime të para Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Poezitë e saj janë përkthyer në disa gjuhë si: italisht, greqisht, maqedonisht, bullgarisht, arumanisht, anglisht. Renditet në disa antologji si brenda dhe jashtë vendit, si dhe në Enciklopedinë Shqiptare të Gazetarëve, në “Leksikoni i shkrimtarëve Shqiptarë 1501-2001, me autor Hasan Hasanin (Shtëpia Botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2003). Është anëtare Nderi e Organizatës Shqiptare Amerikane “Motrat Qiriazit”, (15 janar 2006). Është anëtare e Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve (5 janar 2006). Është Anëtare Nderi e Shoqatës së Ushtarakëve në rezervë-Dega Athinë (13.04.2008) Është anëtare e Klubit të Shkrimtarëve “Drita” dhe Kryeredaktore e Revistës Letrare Artistike “Pelegrin”.

Ka botuar librat: “Më kërkojnë sytë e nënës” (1974), “Ç’u fala stinëve që ikën?” (1988), “Të jesh grua” (1990), “Do të jetoj” (Rozafa-1996), “Trokit dhe zgjo” (“Egnatia”-2000), “Kush ma vrau Ofelinë”, italisht-shqip (Toena-2000), “Për një mollë që hëngri Eva...” (Prishtinë-gusht 2002), “(F) Shihemi në sy” (janar-shkurt 2002), “Pulëbardhë në det’ të zi” (“Ilar” - maj 2002), “Lirika” (Medaur-2003), “Hajku” bashkëautorë (“Egnatia” - 2004), “...Më kërkon falje” (Arbëria-2004), “Poezi” (dy libra në Një) (botimet “Snaj” - 2007). Është vlerësuar me mjaft çmime për vëllime poetik brenda dhe jashtë vendit.

Këndoi vargje për ushtarin

Fluturak Gërmenji ishte shkrimtar, publicist dhe studiues. Ai ka lindur më 21 nëntor 1948, në Tiranë. Ka studiuar në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”, në Fakultetin e Gjuhës e Letërsisë Shqipe në Tiranë. Në vitin 1971, vit që përfundon shkollën fillon punë si redaktor në gazetën e ushtrisë “Luftëtari”. Ka drejtuar revistat ushtarake “10 Korriku”, “Ushtria dhe Koha”. Pas disa vitesh emërohet sekretar i kolegjiut në revistën ushtarako-politike “Mbrojtja” në të cilën punoi për 15 vjet, deri në vitin 1993, dy vitet e fundit si kryeredaktor i saj. Pas lirimit nga ushtria si kolonel në rezervë, në vitin 1994, u angazhua në sektorin privat, deri në vitin 2002.

Ishte anëtar themelues i Shoqatës së Historianëve Ushtarakë dhe Kryetar i Shoqatës “Miqet e Tomsonit”, krijuar në vitin 1996. Ka botuar reportazhe, artikuj e studime historike në të gjitha organet e shtypit. Në vitet 1970-1980 ka botuar librat me poezi “Urim Ushtari”, “Korriku ynë” ne “Valë e detit”. Ka marrë disa çmime kombëtare për poezi dhe në gazetari. Është bashkautor në botimin e tre librave të parë. “Yje të pashuar”. Në vitet 2000-2006 ka qenë Shef i Zyrës së Oborrit Mbretëror Shqiptar. Pas viteve ‘90 ka botuar librat studimorë “Mesazhe Paqeje”, “Familja Mbretërore Shqiptare”, “Mbreti Leka I i panjohur”, “Mbretëresha - Susana”, “Misioni Holandez”, etj. Ndarë nga jeta, më 3 prill 2019.

Në të ardhmen do vijojmë me poetë dhe shkrimtarë të tjerë ushtarakë në vite.

Statuti organik i Shqipërisë ishte akt i hartuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK), më 10.04.1914 dhe njihet si kushtetuta e parë e shtetit shqiptar pas shpalljes së pavarësisë. Statuti përbëhej nga 17 kapituj dhe 216 nene. Aty trajtoheshin disa nga problemet kryesore si forma e qeverisjes, pozita ndërkombëtare e Shqipërisë dhe territori i saj, pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, popullsia, të drejtat dhe detyrat e saj, administrata lokale, forcat e armatosura dhe organet e drejtësisë. Statuti organik e shpallte Shqipërinë “Principatë Sovrane e Trashëgueshme”, me në krye princin gjerman Vilhelm Vidin.

STATUTI ORGANIK I SHQIPËRISË

Pavarësisht nga prania formale e një përfaqësuesi shqiptar në punimet e KNK, në hartimin e SOSH, nuk u tërhoq opinioni i shëndoshë i qarqeve atdhetare dhe nuk u përfillën as rezultatet e arritura nga qeveria kombëtare e Vlorës në organizimin e brendshëm të shtetit të ri me forcat kombëtare. Statuti ishte fryt i politikës së diktatit të 6 Fuqive të Mëdha dhe në shumë pikëpamje një zgjidhje kompromisi për të pajtuar kontradiktat e tyre në çështjen shqiptare.

SOSH përbëhej nga 17 kapituj dhe 216 nene. Aty trajtoheshin disa nga problemet kryesore si forma e qeverisjes, pozita ndërkombëtare e Shqipërisë dhe territori i saj (Kap. I), pushteti legjislativ dhe ekzekutiv (kapitujt II, IV, V), popullsia, të drejtat dhe detyrat e saj (kap. III), administrata lokale (kap. VI), forcat e armatosura (kap. IX), organet e drejtësisë (kap. X). Shqipëria shpallej “Principatë Sovrane e Trashëgueshme” me në krye princin gjerman Vilhelm Vidin, pozita e të cilit si “sovrani” (dhe e trashëgimtarëve të tij) sanksionohej drejtpërsëdrejti në statut. Aty fiksoheshin po ashtu disa nga pikat kryesore të 29 korrikut 1913, të Konferencës së ambasadorëve si: neutraliteti i Shqipërisë nën garancinë e 6 Fuqive, kapitulacionet si një varg të drejtash të posaçme që u njiheshin shtetasve të Fuqive evropiane në territorin shqiptar. Regjimi i sanksionuar nga SOSH ishte një regjim i imponuar nga jashtë, një mohim i të drejtës së vetëqeverisjes së popullit shqiptar dhe një shkelje e hapur e sovranitetit të tij.

Shteti Shqiptar pas shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912, do të kishte vetëm në vitin 1914, ligj themeltar të shtetit, pra një kushtetute, e cila quhej “Statuti Organik”. Ky Statut, për nga renditja e Kushtetutave në këto 109 vite Pavarësi, shënon të parën kushtetutë në historinë e shtetit Shqiptar, por kjo është vetëm për nga renditja, pasi ky Statut u hartua dhe u vendos nga një organ ndërkombëtar i huaj, pra nga Komisioni Ndërkombëtarë i Kontrollit – (KNK). Statuti ose kushtetuta e parë e shtetit Shqiptar është “Bazat e Kanunores së Këshillës së Naltë” e njohur ndryshe si “Statuti i Lushnjës 1920”. Ky Statut përfaqëson kushtetutën e parë Shqiptare për faktin se ky ligj themeltar i shtetit u hartua dhe u miratua nga një Mbledhje Kombëtarë siç ishte Kongresi Kombëtar i Lushnjës (21-31 janar 1920), ku delegatët që merrnin pjesë në këtë mbledhje të rëndësishme për fatet e shtetit Shqiptar ishin përfaqësues të zgjedhur nga populli shqiptar në çdo Prefekturë të Shqipërisë. Statuti i Lushnjës ishte i përkohshëm, pasi Statuti përfundimtar do të miratohej nga Asambleja Kushtetuese. Statuti i Lushnjës qëndroi në fuqi rreth 2 vite. Në Shqipërinë e viteve 1921-1924, pati zhvillime të shumta politike. Në prill të vitit 1921, u zhvilluan për herë të parë zgjedhje parlamentare në Shqipëri. Deputetët e zgjedhur kishin garuar si individë dhe jo si kandidatë të partive politike, ndërsa këto të fundit do të themeloheshin më vonë dhe ato ishin: Partia Popullore dhe Partia Përpamitare. Zhvillimi i zgjedhjeve si dhe krijimi i partive politike shënuan një zhvillim për vendin si dhe në Shqipëri filloi pluralizmi politik. Këshilli Kombëtar (parlamenti) që doli nga këto zgjedhje krijoi një komision të posaçëm prej 12 vetash, për hartimin e projekt Kushtetutës dhe në dhjetor 1922, Këshilli Kombëtar do ta zgjeronte këtë statut dhe statuti i ri do të emërtohej “Statuti i Zgjeruar i Lushnjës”. Forma qeverisëse, që sanksionohej në “Statutin e Zgjeruar të Lushnjës -1922”, ishte e njëjtë si në “Statutin e Lushnjës - 1920”, pra Monarki, por që vendin e Mbretit përkohësisht e zinte Këshilli i Naltë. Në këtë Statut sanksionohej një parim tepër i rëndësishëm siç është ai i ndarjes së pushteteve. Pushtetin legjislativ e ushtronte Parlamenti, pushtetin përmbarues (ekzekutiv) e kishte Këshilli i Naltë, funksion të cilin ai e kryente më anë të Kabinetit (Qeveria/ Këshilli i Ministrave), pushteti gjyqësor ushtrohej nga Gjykatat. “Statuti i Zgjeruar i Lushnjës (1922)”, po ashtu si “Statuti i Lushnjës (1920)”, nuk ishte i përhershëm, por i përkohshëm dhe ndryshimi i “Statutit të Zgjeruar të Lushnjës” nga “Statuti i Lushnjës” ishte vetëm për nga përmbajtja, ngaqë ishte shumë më i madh. Statuti i Zgjeruar i Lushnjës ishte i ndarë në katër kapitula. Kapitula e parë, e emërtuar “Formimi i Shtetit”, ndahej në katër pjesë të emërtuara me gërmat A,B,C,D në pjesën “A” parashikoheshin Dispozitat e përgjithshme “Statuti i Lushnjës - 1920” dhe “Statuti i Zgjeruar i Lushnjës - 1922”, përbëjnë arritje madhore si dhe përfaqësojnë themelet e historisë të së drejtës kushtetuese në Shqipëri.

PUSHTETI LEGJISLATIV – PARLAMENTI NË STATUTIN E ZGJERUAR TË LUSHNJËS (1922)

Parlamenti përbëhej nga deputetë të zgjedhur nga populli me votim universal sipas ligjit. Deputetët zgjidheshin për një mandat 4-vjeçar dhe përgjegjësia e tyre mbaronte me përfundimin e afatit, por për këtë parlament të dalë nga zgjedhjet e vitit 1921, ky mandat nuk u aplikua. Në Statut përcaktoheshin standarde që duhet të plotësoheshin për zgjedhjen e deputetëve. Deputet pranohej vetëm ai që ishte nënshkret shqiptar, që kishte mbushur moshën 25-vjeç, që gëzonte të drejta civile e politike si dhe që plotësonte cilësi të tjera të kërkuara prej ligjit. Detyra e deputetit ishte e papajtueshme me çdo nëpunës të shtetit me rrogë, me nëpunësi komunale si dhe me shërbimin aktiv fetar. Deputeti përfaqësonte jo vetëm qarkun ku e kishin zgjedhur, por të gjithë kombin. Zgjedhësit nuk mund t'i jepnin porosi apo urdhër deputetit të tyre. Deputetët paguheshin për punën që bënin me një pagë 5000 franga ari në vit. Kjo pagë e deputetit mund të



ndryshohej herë pas here me ligj. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të parlamentit përcaktohej në rregulloren e tij të brendshme. Kryesia (Paria) e parlamentit zgjidhej nga vetë parlamenti dhe zgjidheshin individ nga radhët e parlamentit në fillim të çdo sesioni për gjatë gjithë mandatit të parlamentit. Zgjedhja e Kryesisë dhe e nëpunësve të Parlamentit organizohej sipas rregullores së brendshme të tij. Parlamenti kishte detyrë që të shqyrtonte cilësitë dhe fuqitë ligjore të anëtarëve të tij dhe më pas gjykonte dhe vendoste për këto sipas parashikimeve të rregullores së brendshme të tij (Artikulli 14). Secili anëtar i parlamentit bënte dy betime, të parin përpara shqyrtimit të cilësive të tij dhe të dytin, përpara nisjes së mandatit si deputet (Artikulli 15). Deputeti që ishte zgjedhur rishtas dhe që pa arsye të justifikuar dhe të vërtetuara siç duhet, nëse nuk paraqitej për një afat dy mujor përpara Parlamentit që të kryente betimin që sanksionohej në Statut, ai deputet quhej i shkarkuar nga detyra e tij. Parlamenti në këtë rast kishte të drejtën e gjykimit (funksion “quasi gjyqësorë”) në lidhje mbi pranueshmërinë ose jo të arsyeve të justifikimit të deputetit. Deputeti që mungonte për gjashtë muaj rresht në seancat e Parlamentit, pa autorizimin e Parlamentit ishte vetvetiu i shkarkuar nga detyra. Ku vendi i një deputeti mbetej vakant për çfarëdolloj arsye, atëherë brenda dy muajve nga dita e vakantes, por jo më parë se një muaj duhet të zgjidhej një deputet tjetër në vendin e tij. Deputetëve nuk mund t’iu kërkohej llogari apo të mbanin përgjegjësi për votimin apo mendimet e shfaqura në Parlament. Deputetët gjatë sesionit parlamentar nuk mund të gjendeshin në burg për borxh. Deputeti gjatë mandatit të tij kishte imunitet ndaj dhe nuk mund të ndiqej apo arrestohej për çështje penale, pa lejuar dhe vendosur Parlamenti, por më një përjashtim në rast se kapeshin në faj e sipër për krim, atëherë autoritetet gjyqësore kishin për detyrë të njoftonin Parlamentin, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë brenda 24 orëve. Deputetët në rast se kryenin krime politike dhe delikte gjykoeshin dhe dënoheshin gjithmonë, si gjatë por edhe jashtë sesionit parlamentar nga Gjykata e Naltë me autorizimin e Parlamentit, duke u mbështetur në ligjin e posaçëm. Parlamenti kishte të drejtën e dekretimit të lirim të një deputeti të tij për të gjithë periudhën e sesionit nëse kishte qenë kapur në periudhën e pushimeve. Parlamenti zhvillonte sesione të jashtëzakonshme, në të cilat bisedohej vetëm për çështjet për të cilat ky sesion thirrej dhe këto çështje ishin të përcaktuara në një program që hartohej nga Qeveria. Sesionin e jashtëzakonshëm Këshilli i Lartë në çdo kohë që e shikonte të arsyeshme kishte të drejtën e mbylljes së tij, por përherë më përpara fillimit të sesionit normal (të zakonshëm). Këshilli i Lartë në hapjen e sesionit të zakonshëm nëpërmjet një ligjërate ose lajmërimi parashtronte situatën në përgjithësi të shtetit si dhe masat që gjykoeshin të nevojshme që të merreshin në atë vit nga pushteti ekzekutiv (përmbarues) dhe Parlamenti i kthente një përgjigje të shpejtë (Artikulli 24). Parlamenti bisedonte dhe vendoste vetëm kur i pranishëm në të ishte një deputet më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij, të cilët i kishin kaluar formalitetet e parashikuara në artikujt 14 dhe 15 të Statutit. Në llogaritjen e numrit të përgjithshëm të deputetëve Parlamenti nuk përfshinte ata deputet që mungonin me leje. Vendimet në Parlament duhet të votoheshin me shumicë absolute të deputetëve që ishin të pranishëm në mbledhje. Zgjedhjet që i përkisnin personave mënyra e votimit të tyre organizohej me dy raunde, në rast se për herë të parë nuk votoheshin me shumicë absolute, atëherë herën e dytë votoheshin me shumicë relative të deputetëve të pranishëm në mbledhje. Në mbledhjet e parlamentit, mënyrat e votimit ishin të përcaktuara në rregulloren e brendshme sipas rasteve dhe ishin tre mënyra: “Me ngritjen e dorës lart, me thirrjen emërore ose me votim të fshehtë”. Mënyra e votimit të ligjeve nga Parlamenti zhvillohej një herë në parim dhe dy herë nën për nen, në tre ditë të ndryshme, ndërsa për sa i përket kodeve që paraqiteshin nga Qeveria e që ishin për gatitur nga një komision i posaçëm, votimi zhvillohej në bllok në tre mbledhje në ditë të ndryshme, por me përjashtim të ligjeve që Parlamenti me vendim i quante të ngutshme, të cilat votoheshin sipas rregullores së brendshme. Mbledhjet e Parlamentit zhvilloheshin me dymë të hapura si dhe bisedimet e tij botoheshin në vëllime të posaçme. Në parlament, përveç personelit të sigurisë mund të bëhej pjesë e tij cilido, gjithmonë në përputhje me rregulloren. Parlamenti mund të zhvillonte edhe mbledhje me dymë të mbyllura, nëse kjo kërkohej nga ministrat ose deputetët dhe nëse pranohej nga shumica. Mbledhja më dymë të mbyllura zhvillohej pasi personat e ndaluar për të qenë të pranishëm në këtë rast të ishin larguar nga dhoma. Parlamenti nuk mund të dhunohej. Vetëm trupa policore e veçantë mund të qëndronte brenda dhomës ose tek porta e ndërtesës ku zhvillonte punimet parlamenti, ndërsa zyrtarë apo fuqi armësh nuk mund të qëndronin pa kërkesë e vendim të Parlamentit. Të gjitha aktet me fuqi ligjore shpalleheshin në gazetën zyrtare, e cila dërgohej në të gjithë bashkitë e vendit. Shpallja e akteve ligjore duhet të bëhej brenda dy javëve nga dita e votimit dhe akti në fuqi e zbatim hynte një muaj mbas shpalljes me përjashtim të ligjeve që kishin të caktuar një afat ndryshe

